



# Materialet mësimore në MësoVET

---

**Platforma MësoVET** aktualisht numëron 310 kurse të cilat përmbajnë lëndë profesionale, lëndë të përgjithshme, module, kurse trajnimi, libra digjitalë dhe kurse udhëzues. Nga këto, janë zhvilluar me ndihmën e mësuesve dhe ekspertëve të fushës 142 lëndë dhe module profesionale në 8 drejtime dhe janë të disponueshme gjithashtu 33 kurse për lëndë të përgjithshme, 96 kurse në formën e librave digjitalë dhe 39 kurse trajnimi dhe provimesh. Mësovet përditësohet dhe pasurohet me materiale të reja në mënyrë të vazhdueshme, duke iu referuar kurrikulave kombëtare. Për këtë kontribuojnë jo vetëm ekspertë nga industria por janë kapacituar gjithashtu 46 mësues përgjatë 2 viteve të fundit. Procesi i zhvillimit të materialeve mësimore është realizuar duke iu dhënë prioritet drejtimeve me numër më të lartë nxënësish, ku aktualisht studiojnë 72% e nxënësve të shkollave publike profesionale. Më poshtë është shpjeguar shkurtimisht numri i lëndëve të zhvilluara për drejtim, numri i mësuesve dhe nxënësve që iu vijnë në ndihmë këto materiale.

## **Drejtimi Hoteleri-Turizëm**

Janë të disponueshme 52 lëndë dhe module profesionale, të cilat mbulojnë 11 shkolla profesionale dhe iu vijnë në ndihmë 3187 nxënësve dhe 90 mësuesve

## **Drejtimi Ekonomi Biznes**

Janë të disponueshme 30 lëndë dhe module profesionale që mbulojnë 11 shkolla profesionale dhe iu vijnë në ndihmë 1332 nxënësve dhe 67 mësuesve.

## **Drejtimi Elektroteknikë**

Janë të disponueshme 17 lëndë profesionale që mbulojnë 11 shkolla profesionale dhe iu vijnë në ndihmë 1638 nxënësve dhe 33 mësuesve.

## Drejtimi TIK

Janë të disponueshme 27 lëndë dhe module profesionale që mbulojnë 13 shkolla profesionale dhe iu vijnë në ndihmë 1754 nxënësve dhe 79 mësuesve.

## Drejtimi SHMT

Janë të disponueshme 7 lëndë profesionale që mbulojnë 11 shkolla profesionale dhe iu vijnë në ndihmë 2998 nxënësve dhe 86 mësuesve.

## Drejtimi Mekanikë

Janë të disponueshme 7 lëndë profesionale që mbulojnë 10 shkolla profesionale dhe iu vijnë në ndihmë 1059 nxënësve dhe 57 mësuesve.

## Drejtimi Tekstil-Konfeksion


Është e disponueshme 1 lëndë profesionale që mbulon 4 shkolla profesionale.

## Drejtimi Shërbime Sociale dhe Shendetësore

Është e disponueshme 1 lëndë profesionale që mbulon 5 shkolla profesionale.



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:



Zbatuar nga:

